# Vladimir Skënderi

GJYQTAR PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

**Deklaratat e analizuara:**

**16 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018




Pasuria bruto nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2018 është rritur 5.6 herë

+ 1,108,372 Lekë rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**




**Pasuritë e Luajtshme**




**Pasuritë e Paluajtshme**




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2018 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Paga nga funksioni | 15,108,010 | 32.8% |
| Paga e familjarëve | 14,348,505 | 31.2% |
| Mesimdhenia | 1,990,400 | 4.3% |
| Të ardhura nga Qira | 7,100,000 | 15.4% |
| Dhurata ne Cash | 1,667,160 | 3.6% |
| Te ardhura te tjera | 5,790,159 | 12.6% |
| Total | 46,004,234 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 15 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Subjekti Vladimir Skënderi në formularin Periodik/Vjetor 2003 dhe në vazhdim deklaron pronësinë e një toke në Kamëz, ku është ndërtuar godinë banese, lokal dhe garazh pa leje. Edhe në vitet në vazhdim janë bërë shtesa (dhoma) me burim kursimet familjare dhe huamarrje. Në vitin 2013 është bërë legalizimi i banesës dhe lokalit, por nuk deklarohen kostot e procesit të legalizimit.

Gjatë periudhës deklaruese, subjekti ka hua nga të tretët përkatësisht: 10,000 euro nga vëllai i bashkëshortes në vitin 2006; 34,000 USD në vitin 2015 nga vjehrri për mbulimin e shpenzimeve të studimit të djalit në SHBA; dhe 8,600 euro në emër të vajzës me kontratë noteriale në vitin 2017.

Në vitin 2011, deklarohen dhurata monetare me vlerë 12,000 euro nga dasma e vajzës, por nuk deklarohen shpenzimet e kryera.